



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 61 parag. 1.8, të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, si dhe në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, si dhe në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 2019, merr,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK PROPOZIM RREGULLOR PËR ORARIN E PUNËS PËR BIZNESET QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë vendim vëhet në diskutim publik;

Propozim Rregullorja për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 2

Diskutimi publik për propozim Rregulloren sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **01.07.2019 deri më 31.07.2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet më **15.07.2019, në orën 10:00** në objektin e Komunës, salla e Kuvendit.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshime apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.32, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; nazmi.elezi@rks-gov.net dhe bujar.gimolli@rks-gov.net të cilat pastaj i përcjellin në Drejtoria përkatëse.

Neni 4

Dokumenti i propozim Rregullores sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës, <http://kk.rks-gov.net/podujeve> - aktet për diskutim publik, dhe në tabelën e shpalljeve.

Neni 5

Diskutimin dhe debatin publik e zbaton Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që obligohen të përgatitin raportin nga diskutimi publik dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimin ose mospranimin të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.01-401/030052215/19
Podujevë, 28 qershor 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Propozim

**RREGULLORE
PËR ORARIN E PUNËS PËR BIZNESET
QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

Podujevë, qershor 2019

Në bazë të nenit 58 shkronja h) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, nenit 40 të Ligjit për tregtinë e brendshme, nr.2004/18, dhe nenin 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës i,

Propozohet

**RREGULLORE
PËR ORARIN E PUNËS PËR BIZNESET QË OPEROJNË NË
TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për Bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 2

Biznesit, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore fillimin dhe mbarimin e punës.
2. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.

II. Orari i punës

Neni 4

1. Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore, në intervale kohore:

- 1.1. Periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 31 tetor të vitit;
- 1.2. Periudha dimërore fillon më 1 nëntor dhe mbaron më 31 mars të vitit

Neni 5

1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në dyqanet zejtare:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 8:00 - 20:00
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 – 19:00
2. Gjellëtoret, qebaptoret dhe dyqanet e ushqimit të shpejtë punojnë çdo ditë pune:
 - 2.1. Periudha verore, prej orës 6:00 - 23:00;
 - 2.2. Periudha dimërore prej orës 7:00 - 21:00.
3. Ditën e fundjavës (të dielën) dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveç: gjellëtoreve, qebaptoreve, dyqanet e ushqimit të shpejtë, salloneve të ondulimit, floktoreve, autolarjeve, serviset e automjeteve dhe ato të pajisjeve shtëpiake.

Neni 6

1. Orari i punës në Qendrat tregtare, supermarketet dhe dyqane ushqimore, do të jetë:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 7:00 – 23:00;
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 7:00 – 22:00.
2. Orari i punës në dyqanet tregtare të tekstilit, dyqanet e këpucëve, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake “teknikës së bardhë” dhe veprimtarive të tjera jo ushqimore, do të jetë:
 - 2.1. Periudha verore, prej orës 7:00 – 21:00;
 - 2.2. Periudha dimërore, prej orës 7:00 - 20:00.
3. Bizneset tregtare nuk punojnë të dielën dhe ditët e festave.
4. Përjashtim nga pika 3 e këtij neni, do bëjnë bizneset nga pika 1, me që rast u lejohe të punojnë deri në ora 15.00. gjatë ditëve të diela dhe ditëve të festave.

Neni 7

1. Orari i punës në depot e artikujve ushqimorë, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit, do të jetë:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 8:00 - 19:00;
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 – 18.00
2. Ditën e fundjavës (të dielën) dhe gjatë ditëve të festave, depot nuk punojnë.
3. Orari i punës në bizneset ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë), do të jetë:
 - 3.1. Periudha verore, prej orës 7:00 - 18:00.
 - 3.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 - 17:00.
4. Bizneset ndërtimore, në raste të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës së punëve, me leje të posaçme, të cilën e lëshon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00.

Neni 8

1. Orari i punës I bizneseve hoteliere do të jetë:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 7:00 – 24:00;
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 7:00 – 23:00.
2. Orari i punës në hotele, motele është i njëjtë në të dy sezonet dhe fillon prej orës: 00:00 - 24:00.
3. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni do të ketë, sepse mund të punojnë më gjatë se orari i paraparë i punës, por jo më shumë se deri në orën 1:00 të mëngjesit. Për këtë duhet të kërkohet leje e veçantë, të cilën e lëshon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik. Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, 10 € për orë pune.
4. Veprimtarive të lartpërmendura në pikën 2 të këtij neni, nuk iu lejohet shërbimi për mysafirë jashtë objektit pas orës 24:00.

Neni 9

1. Orari i punës në diskoklube, është i njëjtë për të dy sezonet, fillon në orën 20:00 dhe mbaron në orën 3:00 (të mëngjesit).
2. Orari i punës për klubet e natës është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 23:00 dhe mbaron në orën 5:00 (të mëngjesit).
3. Orari i punës për internet - kafe dhe bastore fillon në orën 8:00 dhe mbaron në orën 24:00.

Neni 10

Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat sportive,fitneset, punojnë prej ores 08.00-24.00.

Neni 11

Veprimtarive të parapara në nenet 8, 9 dhe 10 të kësaj Rregulloreje gjatë orarit të punës, nuk iu lejohet t'u prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria.

Neni 12

1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve është:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 6:00 – 19:00.
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 7:00 – 18:00.
2. Tregu i gjelbër nuk do të punojë gjatë ditës së fundjavës (të dielën) dhe ditëve të festave.
3. Tregu i kafshëve punon të shtunave.

Neni 13

Në objektet hoteliere, të cilat gjenden në afërsi deri në 100 m nga objektet e banimit, në të cilat organizohet program me muzikë të gjallë apo me audio - video mjete për reproduktimin e programit, programi nuk mund të vazhdojë pas orës 24 : 00.

Neni 14

Orari i punës në pikat e shitjes së karburanteve është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 00:00 dhe zgjatë deri në orën 24 : 00 (pa ndërprerë).

Neni 15

1. Orari i punës në barnatore, ordianca dhe klinika private do të jetë i njëjtë në të dy sezonet, fillon në orës 7:00 dhe mbaron në orën 22:00.

2. Në raste urgjente, të dielave dhe gjatë festave shtetërore, mund të punojnë edhe jashtë orarit të paraparë sipas paragrafit 15.1.

3. Barnaret që veprojnë në qytet në afërsi të shërbimeve mjekësore, në harmoni me planin për kujdestari, të hartuar në bashkëveprim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, do të kujdestarojnë 24 orë pa ndërprerë.

Neni 16

Furrat e bukës, punojnë prej ores 05.00 deri në 23.00.Përjashtim bëhet gjatë muajit të Ramazanit,pasi mundë të punojnë pa ndërprerje.

Neni 17

1.Bizneset që ofrojnë shërbime të telefonisë, IT-së, mjeksore, arsimore dhe ato financiare punojnë :

1.1. Periudha verore: 7.00-22.00

1.2. Periudha dimërore: 7.00-21.00

2. Të dielave dhe festave zyrtare e kanë ditë pushimi.

Neni 18

1. Bizneset mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave, të parapara me Ligjin për festat zyrtare, deri në orën 1:00 (të mëngjesit).

2. Për të gjitha rastet e parapara në piken 1 të këtij neni, nuk paguhet taksa shtesë.

Neni 19

1. Bizneset prodhuese dhe ato përpunuese mund të punojnë sipas vëllimit dhe nevojave të tyre por duke respektuar standardet, sigurinë dhe qetësinë publike.

2. Bizneset që nuk janë të përfshira në dispozitat e kësaj Rregulloreje e propozojnë orarin e punës të cilin në formë të shkruar me pëlqim e aprovon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

III. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 20

Bizneset do të gjobiten për kundërvajtje, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12,13,14,15,16,17,18 dhe 19 të kësaj Rregulloreje, si më poshtë:

- 1.1. Personat juridik200 – 400 €
- 1.2. Personat fizik100 – 200 €

IV. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 21

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtoria e Inspektionit, Policia e Kosovës dhe Gjykata për Kundërvajtje.

Neni 22

Të gjitha bizneset janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, në afatin tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi.

Neni 23

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e mëparshme.

Neni 24

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, Rregullorja hyn në fuqi pas publikimit në veb faqe.

**Podujevë,
Qershor 2019**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**